



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstvo za Obrazovanje, Nauke i Tehnologija--Ministry of Education Science and Technology

Kabienti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 344/01B

Datë: 23/05/2018

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të nenit 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), neneve 7,8,13,14 dhe 29 të Ligjit nr. 05/L -018 për Provimin e Maturës Shtetërore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 08 Janar 2016, nenit 8 paragrafi 1.4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), dhe propozimit të Kryetarit të Komisionit Shtetëror të Maturës të dt. 23.05.2018, nxjerr:

V E N D I M

Për ndalimin e përhershëm të angazhimit

1. Komisionarëve , Administruesve dhe Monitoruesve të cilët thyjnë rregullat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi për mbajtjen e rregullt të Provimit të Maturës Shtetërore u ndalohet përherë angazhimi në procedurat e mbajtjes së Provimit të Maturës Shtetërore.
2. Obligohet Sekretari i përgjithshëm të zbatoj vendimin
3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e lartshënuara si, propozimit të Kryetarit të Komisionit Shtetëror të Maturës të dt. 23.05.2018, e me qellim të krijimit të kushteve të barabarta për të gjithë nxënësit që i nënshtrohen Provimit të Maturës Shtetërore si dhe duke synuar sanksionimin e shkelësve të dispozitave dhe rregullave të mbajtjes së Provimit të Maturës Shtetërore, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Kabinetit të Ministrit/ MASHT;
2. Zyrës së SP/MASHT;
3. Komisionit Shtetëror të Maturës;
4. DKA;
5. Komisionarëve, Administruesve dhe Monitoruesve dhe
6. Arkivit.

Shyqiri Bytyqi

Ministër MASHT

